

# MENAXHIMI I PARASË PUBLIKE NË SYTË E AUDITORIT TË PËRGJITHSHËM

**RAPORT MBI REKOMANDIMET E AUDITORIT  
TË PËRGJITHSHËM LIDHUR ME MENAXHIMIN  
E PARASË PUBLIKE NGA KOMUNAT:**

**PRIZREN, SUHAREKË, FERIZAJ, LIPJAN, PODUJEVË DHE ISTOG,  
PËR VITIN 2017**



2018



# **MENAXHIMI I PARASË PUBLIKE NË SYTË E AUDITORIT TË PËRGJITHSHËM**

**RAPORT MBI REKOMANDIMET E AUDITORIT  
TË PËRGJITHSHËM LIDHUR ME MENAXHIMIN  
E PARASË PUBLIKE NGA KOMUNAT:**

**PRIZREN, SUHAREKË, FERIZAJ, LIPJAN, PODUJEVË DHE ISTOG,  
PËR VITIN 2017**





COPYRIGHT © 2018. Kosova Democratic Institute (KDI).

Institutit Demokratik i Kosovës i ka të gjitha të drejtat të rezervuara dhe asnjë pjesë e këtij botimi nuk lejohet të riprodhohet ose të transmetohen në çfarëdo forme, mekanike apo elektronike, përfshirë fotokopjimin ose çdo sistem tjetër të ruajtjes dhe nxjerrjes së materialeve, pa lejen me shkrim të botuesit. Publikimi mund të riprodhohet ose të transmetohet vetëm nëse përdoret për qëllime jokomerciale. Kurdo dhe kushdo që përdor citate a materiale të ndryshme të këtij botimi, është i obliguar ta bëjë të qartë burimin nga do t'i ketë marrë ato citate ose materialeve që përdoren.

Për çdo koment, kritikë apo sugjerim, luteni të na kontaktoni përmes mundësive të ofruara më poshtë:

Adresa: Rr. Bajram Kelmendi, Nr. 45,

10000, Prishtinë, Kosovë.

Tel.: +381 (0)38 248 038



E-mail: [info@kdi-kosova.org](mailto:info@kdi-kosova.org)

Web: [www.kdi-kosova.org](http://www.kdi-kosova.org)

**Punuar nga:** Diana Metushi Krasniqi, Bekim Krasniqi, Linda Simitçiu, Erolina Morina, Abedin Imami, Shpend Sopa

Publikimi i këtij raporti është bërë i mundur nga mbështetja bujare e popullit amerikan përmes Agjencisë së Shteteve të Bashkuara për Zhvillim Ndërkombëtar (USAID). Përmajtja është përgjegjësi e Institutit Demokratik të Kosovës - Transparency International Kosovë dhe nuk pasqyron domosdoshmërisht pikëpamjet e USAID-it ose të Qeverisë së Shteteve të Bashkuara.

# PËRMBAJTA



Lista e shkurtesave .....	6	Komuna e Lipjanit .....	35
Hyrje .....	7	1. Opinioni i auditorit	
Metodologjia.....	8	2. Çështjet e identifikuar nga Auditori	
Korniza Ligjore .....	8	3. Krahasimi i çështjeve 2015-2016-2017	
Regullimi ligjor i statusit të auditorit.....	9	4. Problemet sistematike	
Mekanizmat ekzistues të llogaridhënies së institucioneve buxhetore për rekomandimet e auditorit .....	10	5. Përmbledhje	
Çfarë thonë Raportet e Auditimit dhe si trajtohen ato nga komunat .....	12	6. Rekomandime	
Konkluzionet dhe rekomandime .....	15	Komuna e Podujevës.....	41
Komuna e Prizrenit.....	17	1. Opinioni i auditorit	
1. Opinioni i auditorit		2. Çështjet e identifikuar nga Auditori	
2. Çështjet e identifikuar nga Auditori		3. Krahasimi i çështjeve 2015-2016-2017	
3. Krahasimi i çështjeve 2015-2016-2017		4. Problemet sistematike	
4. Problemet sistematike		5. Përmbledhje	
5. Përmbledhje		6. Rekomandime	
6. Rekomandime		Komuna e Istogut .....	47
Komuna e Suharekës .....	23	1. Opinioni i auditorit	
1. Opinioni i auditorit		2. Çështjet e identifikuar nga Auditori	
2. Çështjet e identifikuar nga Auditori		3. Krahasimi i çështjeve 2015-2016-2017	
3. Krahasimi i çështjeve 2015-2016-2017		4. Problemet sistematike	
4. Problemet sistematike		5. Përmbledhje	
5. Përmbledhje		6. Rekomandime	
6. Rekomandime		Shpjegim i llojeve të ndryshme të opinionëve të aplikuara nga ZKA .....	52
Komuna e Ferizajt .....	29	Lista e raporteve të Auditorit: .....	53
1. Opinioni i auditorit			
2. Çështjet e identifikuar nga Auditori			
3. Krahasimi i çështjeve 2015-2016-2017			
4. Problemet sistematike			
5. Përmbledhje			
6. Rekomandime			



# LISTA E SHKURTESAVE

INTOSAI	International Organization of Supreme Audit Institutions (Organizata Ndërkombëtare e Institucioneve supreme të Auditimit)
ISO	International Organization for Standardization (Organizata Ndërkombëtare për Standarde)
ISSAI	International Standards of Supreme Audit Institutions (Standartet Ndërkombëtare për Institucionet Supreme të Auditimit)
KDI	Kosova Democratic Institute / Instituti Demokratik i Kosovës
KA	Komiteti i Auditimit
LMFPP	Ligji për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë
LPP	Ligji për Prokurim Publik
LLA	Llogaritë e Arkëtueshme
NjAB	Njësia e Auditimit të Brendshëm
OB	Organizatë Buxhetore
OJQ	Organizata Jo- Qeveritare
PV	Planin e Veprimit
ZKA	Zyra Kombëtare e Auditimit



# HYRJE

Qeveria e Kosovës ka bërë një progres për sa i përket përmirësimit të sistemit për menaxhimin e financave publike, duke azhurnuar dhe qartësuar legjislacionet përkatëse. Megjithatë, Kosova vazhdon të ballafaqohet me probleme nga më të ndryshmet për sa i përket planifikimit operativ, raportimit të brendshëm menaxherial, kontrollit të brendshëm financiar, prokurimit dhe menaxhimit të investimeve kapitale<sup>1</sup>. E kjo si pasojë e mungesës së angazhimit të mirëfilltë institucional në menaxhim të mirë, sundim të ligjit dhe luftën kundër korrupsionit. Këto brenga vazhdojnë të shpërfaqen vit pas viti si në raportet ndërkombëtare<sup>2</sup>, po ashtu edhe në raportet vendore si ato të Zyrës Kombëtare të Auditimit (ZKA)<sup>3</sup>, Agjencisë Kundër Korrupsionit<sup>4</sup> dhe organizata të ndryshme të Shoqërisë Civile<sup>5</sup>.

Me qëllim të promovimit të standardeve më të larta të transparencës, përgjegjësisë dhe llogaridhënies në menaxhimin financiar dhe mbarëvajtjen e aktiviteteve në administratën publike të Kosovës, me 05 qershor 2008 Kuvendi i Kosovës kishte miratuar Ligjin Nr. 03/L-075 për themelimin e Zyrës së Auditorit të Përgjithshëm dhe Zyrës së Auditimit të Kosovës<sup>6</sup>. Në qershor 2016 ka hyrë në fuqi Ligji Nr. 05/L-055 për auditorin e përgjithshëm dhe zyrën kombëtare të Auditimit të Republikës së Kosovës<sup>7</sup>, i cili ka shfuqizuar ligjin paraprak. Raportet e Auditorit të Përgjithshëm çdo vit pasqyrojnë probleme të ndryshme të institucioneve lidhur me mekanizmat e menaxhimit të mirë të parasë publike, madje edhe shkelje ligjore, megjithatë rekomandimet e tyre vazhdojnë të përsëriten nga viti në vit<sup>8</sup>. Ndonëse këto raporte janë publike, dhe gjithashtu institucionet prezantojnë në Kuvend planet e veprimit për adresimin e çështjeve të identifikuara nga auditori, si mungesë e mekanizmave llogaridhënës, këto plane mbesin të porealizuara, dhe qasja e institucioneve pa shumë përmirësime. Nga viti 2016, Auditori ka filluar të dërgoj në prokurori raportet e auditorit<sup>9</sup>, dhe kanë filluar disa hetime ndaj këtyre shkeljeve, megjithatë, jo të gjitha shkeljet e identifikuara nga auditori janë shkelje penale, dhe ato administrativet vazhdojnë të mbesin të pa ndëshkuara.

1 Raporti Vjetor i Auditimit 2017, [http://www.zka-rks.org/wp-content/uploads/2018/08/RVA-2017\\_Shqip.pdf](http://www.zka-rks.org/wp-content/uploads/2018/08/RVA-2017_Shqip.pdf)

2 KE: Raporti për Kosovën 2016, [https://eeas.europa.eu/sites/eeas/files/20161109\\_kosovo\\_report\\_2016\\_alb.pdf](https://eeas.europa.eu/sites/eeas/files/20161109_kosovo_report_2016_alb.pdf); KE: Strategjia e zgjerimit 2018, [http://www.mei-ks.net/repository/docs/db\\_mie-alb\\_final-enlargement\\_strategy\\_2018.pdf](http://www.mei-ks.net/repository/docs/db_mie-alb_final-enlargement_strategy_2018.pdf)

3 Raporti Vjetor i Auditimit 2016, <http://www.zka-rks.org/publications>; Raporti Vjetor i Auditimit 2017, [http://www.zka-rks.org/wp-content/uploads/2018/08/RVA-2017\\_Shqip.pdf](http://www.zka-rks.org/wp-content/uploads/2018/08/RVA-2017_Shqip.pdf)

4 Opinionet e AKK: <http://www.akk-ks.org/sq/opinionet>

5 Prokurimi i paadresuar – Editorial nga Demokraci Plus (D+) 12.06.2018; Instituti GAP: Luftimi i korrupsionit përmes transparencës buxhetore dhe rishikimit të raporteve të auditorit të përgjithshëm, 05.12.2016; KDI: Shkeljet në prokurim dominojnë në raportet e auditorit, 01.08.2017

6 Ligji Nr. 03/L-075 për themelimin e zyrës së auditorit të përgjithshëm he zyrës së Auditimit të Kosovës: Kuvendi i Kosovës: [http://www.kuvendikosoves.org/common/docs/ligjet/2008\\_03-L075\\_al.pdf](http://www.kuvendikosoves.org/common/docs/ligjet/2008_03-L075_al.pdf)

7 Ligji Nr. 05/L-055 për auditorin e përgjithshëm dhe zyrën kombëtare të Auditimit të Republikës së Kosovës: <https://gzk.rks-gov.net/ActDocumentDetail.aspx?ActID=12517>

8 Plani Strategjik i Zyrës Kombëtare të Auditimit 2018-2021 (<http://www.zka-rks.org/wp-content/uploads/2018/09/Strategjia-2018-07-13-ALB.pdf>)

9 Sipas komunikimit me ZKA të datës 24 tetor 2018: "Zyra Kombëtare e Auditimit dhe Prokuroria kanë bashkëpunim ndër-institucional të vazhdueshëm sipas përgjegjësisë dhe mandatit të tyre. Në kuadër të kësaj hyn edhe komunikimi/ informimi i Prokurorisë për rastet kur gjatë auditimit vërehet se ka elemente të dyshimit për shkelje apo veprë penale."



Koalicioni i Organizatave Jo-qeveritare (OJQ), i përbërë nga Asociacioni i të Rinjëve për të Drejtat e Njeriut (YAHR), Instituti për Qëndrueshmëri dhe Zhvillim të Rinisë (ISDY), Syri i Vizionit, Ekovizioni (EV) dhe Instituti Demokratik i Kosovës (KDI), përmes këtij raporti synon të shpërfaqë problemet e vazhdueshme dhe sistematike në realizimin e buxhetit, fushën e prokurimit publik, investimet kapitale, menaxhimin financiar, funksionimin e Njësisë së Auditimit të Brendshëm dhe zbatimin e rekomandimeve të ZKA nga viti paraprak, të evidentuara në raportet e Auditorit të Përgjithshëm e të cilat kërkojnë vëmendje nga qeverisja lokale si dhe nga institucionet qendrore. Për të pasur një pasqyrë të qartë për problemet e komunave në menaxhimin e financave publike përmes procedurave të prokurimit, koalicioni i OJQ-ve ka analizuar raportet e publikuara të Auditimit të rregullsisë të ZKA për vitin 2017, për Komunat: Prizren, Suharekë, Ferizaj, Lipjan, Podujevë dhe Istog.



Për të pasur një pasqyrë të qartë për problemet e komunave në menaxhimin e financave publike përmes procedurave të prokurimit, koalicioni i OJQ-ve ka analizuar raportet e publikuara të Auditimit të rregullsisë të ZKA për vitin 2017, për Komunat: Prizren, Suharekë, Ferizaj, Lipjan, Podujevë dhe Istog.





# METODOLOGJIA

Ky raport është i bazuar në analizën dhe vlerësimin e të dhënave cilësore dhe sasiore të pasqyruara në raportet e auditimit të pasqyrave financiare të Zyrës Kombëtare

të Auditimit për komunat e Prizrenit, Suharekës, Ferizaj, Lipjanit, Istogut dhe Podujevës, për vitin 2017.

## KORNIZA LIGJORE

### Rregullimi ligjor i statusit të Auditorit të Përgjithshëm

Auditori i Përgjithshëm i Republikës së Kosovës është institucioni më i lartë i kontrollit ekonomik dhe financiar, i cili me Kushtetutë dhe ligjet e vendit gëzon pavarësi funksionale, financiare dhe operative.<sup>10</sup>

Auditimi i rregullsisë është një mekanizëm i mandatuar ligjërisht për kontrollin e cilësisë me theks në kontrollin e rregullsisë së proceseve në menaxhimin e parasë publike<sup>11</sup>. Pra ky auditim ka të bëjë me verifikimin që proceset po punojnë brenda procedurave të përcaktuara. Këto

auditime luajnë një rol të veçantë meqë në fokus kanë menaxhimin e parasë publike nga të cilat varet direkt zhvillimi i politikave shtetërore dhe mirëqenia e qytetarëve.

Sipas INTOSAI<sup>12</sup>, Institucionet Supreme të Auditimit kryejnë tre lloje të auditimeve: Financiare, të pajtueshmërisë dhe të performancës. Në rastin konkret ndërlidhur me këtë raport, auditimet financiare fokusohen nëse informatat financiare të një entiteti janë të prezentuara sipas kornizës rregullatore dhe kërkesave mbi raportimin financiar<sup>13</sup>. Auditimi i rregullsisë ose auditimi ligjor është një auditim financiar i raportimit financiar ose raportimit të buxhetit të subjektit të audituar. Në një auditim të rregullsisë, raporti i auditimit përmban opinionin e auditorit

<sup>10</sup> [\(Zyra kombëtare e auditimit, për ne- Auditori i Përgjithshëm> nuk mundet me qene keshtu Auditori i pergjithshem mundet me qene per ne Auditori. Por ZKA nuk mundet me qene AP\)](#)

<sup>11</sup> [\(Çka është ISO 19011:2011\)](#)

<sup>12</sup> INTOSAI (Organizata Ndërkombëtare e Institucioneve Supreme të Auditimit) vepron si një organizatë ombrellë për komunitetin e auditimit të jashtëm të qeverisë. INTOSAI është një organizatë autonome, e pavarur dhe jo politike. Është një organizatë joqeveritare me status të veçantë konsultativ me Këshillin Ekonomik dhe Social (ECOSOC) të Kombeve të Bashkuara (<http://www.intosai.org>). Kosova nuk është anëtare e INTOSAI, mirëpo operon kundrejt këtyre standardeve, me synim të anëtarësimit në INTOSAI dhe EUROSAI.

<sup>13</sup> ISSAI 100 – Fundamental Principles of Public-sector Auditing, page 5, paragraph 1



lidhur me performancën financiare të institucionit të audituar.

Ligji Nr. 03/L-048 për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë (LMFPP)<sup>14</sup>. KREU II, Auditimi i jashtëm, definojnë nevojën, të drejtën dhe përgjegjësitë e Auditorit të Përgjithshëm. Përderisa, organizimi, veprimtaria, dhe kompetencat e Auditorit të Përgjithshëm si dhe themelimi, organizimi dhe funksionimi i Zyrës Kombëtare të Auditimit të Republikës së Kosovës janë të rregulluara përmes Ligjit Nr. 05/L-055 për Auditorin e Përgjithshëm dhe Zyrën Kombëtare të Auditimit të Republikës së Kosovës<sup>15</sup>.

Qëllimi i auditimeve të rregullsisë është të ekzaminohen dhe vlerësohen nëse pasqyrat financiare të Organizatave Buxhetore japin një pamje të drejtë dhe të vërtetë të llogarive dhe çështjeve financiare për periudhën e auditimit; nëse të dhënat financiare, sistemet dhe transaksionet janë në pajtim me ligjet dhe rregulloret në fuqi, si dhe për përshtatshmërinë e funksioneve të kontrollit të brendshëm dhe të auditimit të brendshëm<sup>16</sup>.

## Mekanizmat ekzistues të llogaridhënies së institucioneve buxhetore për rekomandimet e Auditorit të Përgjithshëm

Komunat e Kosovës janë institucione me kompetenca vetanake, që u ipen me Kushtetutën e Kosovës. Ato udhëhiqen nga Kryetari dhe Kuvendi i Komunës të cilëve u buron mandati nga zgjedhjet komunale të mbajtura çdo 4 vite. Komunat si Organizata Buxhetore (OB) menaxhojnë me buxhetin e tyre që krijohet nga të hyrat vetanake, granti qeveritar dhe donacionet. Kryetari duhet të prezan-

toj strategjitë, buxhetin, raportet dhe aktet ligjore para asamblistëve në Kuvend Komunal për diskutim dhe miratim. Gjithashtu, aktet ligjore të komunave rishikohen edhe nga Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal, e cila ka për obligim për t'u siguruar se kompetencat e deleguara janë ekzekutuar në përputhje me rregullat, kriteret dhe standardet e përcaktuar nga qeveria qendrore.

Puna e Auditorit të Përgjithshëm dhe Zyrës Kombëtare të Auditimit mbështetet nga ligjet për sigurimin e menaxhimit të mirë të parasë publike të referuara nën "Rregullimi ligjor i statusit të Auditorit të Përgjithshëm." Sipas Ligjit për Menaxhim të Financave Publike dhe Përgjegjësitë (LMFPP) dhe Ligjit për Auditorin e Përgjithshëm dhe Zyrën Kombëtare të Auditimit (ZKA), pas përfundimit të auditimeve, të gjitha institucionet buxhetore, brenda një afati 30 ditor, duhet të dorëzojnë planin e veprimit për adresimin e rekomandimeve të Auditorit të Përgjithshëm, pas publikimit të raportit auditues. Të gjitha raportet e auditimit përfshirë edhe ato për komunat, prezantohen edhe në kuvendin e Kosovës<sup>17</sup>. Komisioni për Mbikëqyrjen e Financave Publike, pranë Kuvendit të Kosovës, është përgjegjës për shqyrtimin e të gjitha raporteve të audituara, të rregullsisë dhe të performancës së shpenzimeve financiare, si pjesë e mbikëqyrjes së fondeve publike, agjencive publike, ndërmarrjeve publike, dhe instituteve publike të financuara nga buxheti i Republikës së Kosovës. Në rastin e komunave, raportet finale të auditimit i dorëzohen edhe Kuvendeve Komunale.

Korniza ligjore Kosovës<sup>18</sup> përfshinë disa dispozita, të cilat rregullojnë llogaridhënien e institucioneve buxhetore kundrejt zbatimit të rekomandimeve të auditorit. Sipas ligjit aktual mbi auditimin, ZKA duhet të njoftoj organet kompetente për zbatimin e ligjit kur vëren se ka shkelje ligjore. Nëse kjo bëhet pa ndikuar në hetime, udhëheqësi më i lartë i institucionit që i nënshtrohet auditimit do të

<sup>14</sup> Ligji Nr. 03/L-048 për menaxhimin e financave publike dhe përgjegjësitë (<https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=2524>)

<sup>15</sup> Ligji Nr. 05/L-055 për Auditorin e Përgjithshëm dhe Zyrën Kombëtare të Auditimit të Republikës së Kosovës (<https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=12517>)

<sup>16</sup> Zyra Kombëtare e Auditimit, Raportet e Auditimit: Fushëveprimi dhe metodologjia e auditimit

<sup>17</sup> Ligji Nr. 05/L-055 për Auditorin e Përgjithshëm dhe Zyrën Kombëtare të Auditimit, Neni 23 Raportet e Auditorit (<https://gzk.rks-gov.net/ActDocumentDetail.aspx?ActID=12517>)

<sup>18</sup> Kushtetuta së Kosovës, Ligji Nr. 03/L-048 për menaxhimin e financave publike, Ligji Nr. 04/L-042 për prokurimin publik në Republikën e Kosovës, Ligji Nr. 03/L-215 për Qasje në Dokumente Publike.





informohet gjithashtu<sup>19</sup>. Gjithashtu, sipas LMFP, Zyrtari Kryesor Administrativ (Kryetari i Komunës/ Udhëheqësi i institucionit) ka për detyrë “njoftimin e Auditorit të Përgjithshëm për të gjitha rastet ku me arsye dyshohet se ka pasur shkelje nga një person ose ndërmarrje të këtij ligji, Rregullave të Kontrollit dhe Menaxhimit Financiar (KMF) ose ndonjë ligji tjetër<sup>20</sup>”.

Ligji për Auditorin e Përgjithshëm dhe LMFP, nuk parashohin dispozita konkrete/adekuate që ndëshkojnë komunat nëse ato dështojnë të përmbushin ose adresojnë rekomandimet që dalin nga raportet e Auditorit të Përgjithshëm. Për pasojë, raportet vjetore të rregullsisë të Auditorit të Përgjithshëm, vazhdojnë të shpërfaqin shkelje të njëjta vit pas viti dhe mos adresim të rekomandimeve nga viti paraprak, ndërsa OB mbeten imune ndaj ndëshkimeve. Prokuroria e Shtetit është i vetmi autoritet që do mund të vepronte në rastet e shkeljeve të vazhdueshme, ashtu që të filloi hetimet penale kundër kryetarit të komunës dhe zyrtarëve të tjerë që obligohen të implementojnë rekomandimet e auditorit.

Megjithatë, ligji për menaxhimin e financave publike dhe përgjegjësitë me ndryshimet e tij<sup>21</sup> adreson llogaridhënien dhe përgjegjësitë lidhur me dështimet sistematike në menaxhimin e parasë publike. Nëse gjatë funksionimit të mbikëqyrjes menaxheriale, kontrolleve të brendshme, auditimit të brendshëm dhe/ ose auditimit të jashtëm konstatohet se ka pasur dështim sistematik për kryerjen e detyrës nga Zyrtari Kryesor Financiar<sup>22</sup> ose Zyrtari Certifikues, Zyrtari Kryesor Administrativ<sup>23</sup> merr masa disiplinore deri te shkarkimi i personit në fjalë nga pozita përkatëse<sup>24</sup>. Zyrtarët Financiar<sup>25</sup> të shkarkuar në këtë mënyrë, nuk mund të emërohen si Zyrtarë Financiar në asnjë Organizatë Buxhetore<sup>26</sup>.

19 Ligji Nr. 05/L-055 për Auditorin e Përgjithshëm dhe Zyrën Kombëtare të Auditimit, Neni 24 Informacioni për autoritetet e zbatimit të ligjit

20 Ligji Nr. 03/L-048 për enaxhimin e financave publike dhe përgjegjësitë (<https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=2524>)

21 Ligji Nr. 03/L-221, 10 gusht 2010; Ligji Nr. 04/L-116, 18 korrik 2012; Ligji Nr. 04/L-194, 07 gusht 2013; Ligji Nr. 05/L-063, 06 janar 2016; Ligji Nr. 05/L-007, 21 prill 2016;

22 Ligji nr.03/L-048, Neni 12: Zyrtari Kryesor Financiar: paragrafi 12.1 Çdo organizatë buxhetore, agjenci autonome ekzekutive dhe ndërmarrje publike duhet ta ketë Zyrtarin Kryesor Financiar; Paragrafi 12.4 Çdo ZKF është përgjegjës për veprimtarinë e rregullt dhe të ligjshme financiare të organizatës përkatëse buxhetore, agjencisë autonome ekzekutive ose ndërmarrjes publike.

23 Ligji nr. 03/L-48, Neni 1 Përkufizimet: “Zyrtari Kryesor Administrativ” ose “ZKA”- do të thotë (i) për komunën, kryetarin e komunës, dhe (ii) për organizatat e tjera buxhetore: (a) Sekretarin e Përhershëm, (b) nëse organizata nuk ka Sekretar të Përhershëm, atëherë Kryeshefin Ekzekutiv, ose (c) nëse organizata nuk ka as Sekretar të Përhershëm dhe as Kryeshef Ekzekutiv, atëherë personin e autorizuar për administrimin e përditshëm të organizatës dhe personelit. 10.1: Zyrtari Kryesor Administrativ ka përgjegjësinë kryesore ligjore për të siguruar që organizata buxhetore, agjencia autonome ekzekutive ose ndërmarrja publike dhe personeli i saj të jenë në përputhshmëri të plotë si dhe të respektojnë dispozitat e zbatueshme të këtij ligji dhe Rregullat KMF. Ndër të tjera, ZKA 10.2 Zyrtari Kryesor Administrativ, është shprehimisht përgjegjës për: a) vendosjen e kontrollit të brendshëm në organizatën buxhetore, agjencinë autonome ekzekutive ose ndërmarrjen publike sipas Rregullave KMF; b) delegimin e funksioneve për mbledhjen dhe shpenzimin e parave publike në pajtim me Rregullave KMF; c) vendosjen e një kornize për vlerësimin dhe menaxhimin e përformansës së personelit të organizatës buxhetore të cilëve u janë deleguar funksionet e tilla; d) vendosjen dhe zbatimin e masave të brendshme disiplinore për tu zbatuar në raste kur personeli nuk i ushtron funksionet e deleguara në mënyrë adekuate apo të rregullt; dhe e) njoftimin e Auditorit të Përgjithshëm për të gjitha rastet ku me arsye dyshohet se ka pasur shkelje – nga një person ose ndërmarrje – të këtij ligji, Rregullave KMF ose ndonjë ligji tjetër.

24 Sipas informative të pranuar në KDI nga MF dhe MAP me datën 24 tetor 2018, deri më tani nuk ka shënime të ndëshkimeve apo masave disiplinore të Zyrtarëve Financiar për dështime sistematike në përmbushjen e përgjegjësië të përcaktuara nga ligji për menaxhimin e financave publike dhe përgjegjësitë.

25 Ligji nr. 03/L-048 Neni 1 Përkufizimet: “Zyrtari Financiar” - nënkupton dhe përfshin Zyrtarin Kryesor Administrativ, Auditorin e Brendshëm, Zyrtarin Kryesor Financiar, Zyrtarin e Prokurimit dhe Zyrtarin e Certifikimit.







26 Ligji nr. 03/L-048 Neni 1 përkufizimet: -“Organizatë Buxhetore”- do të thotë një autoritet ose ndërmarrje publike e cila drejtpërdrejtë pranon një ndarje buxhetore sipas Ligjit mbi Ndarjet Buxhetore, ndarje buxhetore kjo që nuk është pjesë e një ndarje tjetër të përgjithshme buxhetore e cila i është bërë një autoriteti ose ndërmarrje tjetër publike.





## Çfarë thonë Raportet e Auditimit dhe si trajtohen ato nga komunat

Duke krahasuar raportet e Auditorit të Përgjithshëm për vitin 2017 për komunat, pjesë të këtij raporti, vërehet se komunat ballafaqohen me probleme sistematike, që lidhen me menaxhimin e parasë publike. Tabela në vijim pasqyron çështjet e njëjta apo ngjashme për aktivitete të veçanta, për gjashtë komunat e trajtuara:







Komuna / Aktiviteti	Prizren	Suharekë	Ferizaj	Lipjan	Podujevë	Istog
						
<b>Realizimi i Buxhetit</b>	Niveli i ulët i realizimit të buxhetit	Realizimi i ulët i buxhetit për investime kapitale	Edhe pse, komuna e Ferizajt ka shpenzuar 95% të buxhetit final, komuna ka paguar dhe raportuar gabimisht shpenzimet për mallra dhe shërbime në vlerë 434,732€ nga kategoria e investimeve kapitale. <sup>27</sup>	Realizimi i ultë i buxhetit për subvencione dhe investime kapitale	Niveli i ulët i realizimit të buxhetit të investimit kapitale	Niveli i ulët i realizimit të buxhetit për investime kapitale
<b>Planifikimi i prokurimeve</b>	<ol style="list-style-type: none"> <li>Pagesa për mallra dhe shërbime pa procedura të prokurimit</li> <li>Planifikim dhe menaxhim i dobët i kontratave</li> </ol>		<ol style="list-style-type: none"> <li>Tejkalim i vlerës së kontratës në raport me kornizën buxhetore për projekte</li> <li>Pagesa e faturave duke e shfrytëzuar buxhetin e projekteve tjera</li> </ol>	Zotimi i mjeteve pas nënshkrimit të kontratës	<ol style="list-style-type: none"> <li>Mangësi në procesin e pagesave</li> <li>Hyrje në kontrata pa mjete të buxhetuara</li> </ol>	1 . Nënshkrimi i kontratave pa mbulesë të fondeve për vitin pasues

<sup>27</sup> Phone services, cleaning, health services, maintenance of street signs, etc.



MENAXHIMI I PARASË PUBLIKE NË SYTË E AUDITORIT TË PËRGJITHSHËM







|||||

Komuna / Aktiviteti	Prizren	Suharekë	Ferizaj	Lipjan	Podujevë	Istog
						
<b>Procedurat tenderuese</b>	Shmangie nga procedurat e rregullta të prokurimit	<ol style="list-style-type: none"> <li>Mos përmbushje e kërkesave të dosjes së tenderit (kriteri profesional)</li> <li>Vlefshmëria e sigurisë së ekzekutimit e pamjaftueshme</li> </ol>		<ol style="list-style-type: none"> <li>Dobësi në procesin e prokurimit</li> <li>Ndarje jo e duhur e detyrave në proceset e prokurimit</li> </ol>	<ol style="list-style-type: none"> <li>Mos ndarja e përgjegjësisë në mes të komisioneve</li> <li>Ndarja e tenderëve dhe përdorimi i procedurave minimale</li> </ol>	<ol style="list-style-type: none"> <li>Mangësi në vendosjen e kriterëve tek aktiviteti i prokurimit</li> <li>Mosrespektim i procedurës për konfiskimin e sigurisë së tenderit</li> <li>Mosrespektim i legjisllacionit përkatës në formimin e komisioneve të vlerësimit</li> </ol>
<b>Menaxhimi i Kontratave</b>	Dobësi sistematike në menaxhimin e kontratave për investime kapitale		<ol style="list-style-type: none"> <li>Dobësi në menaxhimin e kontratave</li> <li>Mungesa e raportit për shërbimet e kryera dhe mos ndalja e tatimit</li> <li>Pranimi i mallrave pa komision</li> </ol>	Dobësi në prokurim dhe menaxhim të kontratave	Vonesat në realizimin e projekteve kapitale	
<b>Pagesat</b>	Pagesat e gjobave i pasojë vonesave në kryerjen e obligimeve		Mungesa e dokumentacionit të obligimeve të paguara	<ol style="list-style-type: none"> <li>Keq klasifikim i shpenzimeve si pasojë e pagesave me vendim gjyqësorë</li> <li>Menaxhim jo i duhur i obligimeve</li> </ol>	Pagesa direkt nga Thesari	Pagesa pa dëshmi të mjaftueshme

|||||

## TRANSPARENCA DHE KUNDËRKORRUPCIONI

|||||

Komuna / Aktiviteti	Prizren	Suharekë	Ferizaj	Lipjan	Podujevë	Istog
						
<b>Zbatimi i rekomandimeve të ZKA nga viti paraprak</b>	Nivel i ulët i zbatimit të rekomandimeve nga viti paraprak dhe viti i mëhershëm	Nivel i ulët i zbatimit të rekomandimeve nga viti paraprak dhe viti i mëhershëm	Nivel i ulët i zbatimit të rekomandimeve nga vitet paraprake	Zbatimi i ultë i rekomandimeve nga viti paraprak dhe viti i mëhershëm	Nivel i ulët i zbatimit të rekomandimeve nga viti paraprak dhe viti i mëhershëm	Nivel i ulët i zbatimit të rekomandimeve nga vitet paraprake
<b>Njësia e Auditimit të Brendshëm</b>	Nivel i ulët i zbatimit të rekomandimeve të NJAB-së	Funksionim jo i plotë i komitetit të auditimit	Nivel i ulët i zbatimit të rekomandimeve të auditimit të brendshëm		Funksionimi i NJAB-së	Funksionimi i kufizuar i NJAB-së dhe KA-së
<b>Kontrollet menaxheriale dhe menaxhimi i rrezikut</b>	Dobësi në kontrollet menaxheriale dhe menaxhimin e rrezikut	Dobësi në kontrollet menaxheriale dhe menaxhimin e rrezikut	Dobësi në kontrollet menaxheriale dhe menaxhimin e rrezikut	Dobësi në kontrollet menaxheriale dhe menaxhimin e rrezikut	Dobësi në kontrollet menaxheriale dhe menaxhimin e rrezikut	Dobësi në kontrollet menaxheriale dhe menaxhimin e rrezikut

Nga tabela e më sipërme shohim se komunat kanë probleme të përbashkëta lidhur me realizimin e buxhetit për investime kapitale, zhvillimin e proceseve të prokurimit, pagesën e obligimeve, menaxhim të kontratave, zbatim të rekomandimeve të ZKA, funksionim të mirëfilltë të Njesisë së Brendshme të Auditimit (NJAB) dhe dobësi në kontrollet menaxheriale dhe menaxhimin e rreziku.



# KONKLUZIONET DHE REKOMANDIME

Kosova ka disa ligje, rregullore dhe udhëzues administrative që adresojnë auditimin dhe mbikëqyrjen e financave publike. Megjithatë ajo që mungon është legjislacioni i cili parasheh masat konkrete për rritjen e llogaridhënies, dhe sanksionet në rast të mos zbatimit të këtyre ligjeve. Ndërkohë që jo të gjitha gjetjet e Auditorit janë të kualifikueshme që të hetohen nga prokuroria, është e nevojshme që të instalohen mekanizma, të cilët sigurojnë zbatimin e rekomandimeve, qoftë si masa ndëshkuese, sanksione apo edhe masa administrative. Janë një numër i gjetjeve të cilat përsëriten nga viti në vit në raportet e Zyrës Kombëtare të Auditimit (ZKA). Të njëjtat janë evidentuar edhe në raportet që mbulojnë vitin 2017, në komunat përkatëse.

Raportet e ZKA pasqyrojnë çështje lidhur planifikimet e dobëta, realizimet e buxhetit, probleme të vlerësimit, hyrja në obligime pa zotim të fondeve, vonesa në pagesa të faturave, ndarja e prokurimeve në vlera minimale, etj. Të mund të konsiderohen si probleme sistematike të cilat përsëriten nga viti në vit. Këto raporte në vijim paraqesin shqetësime lidhur me planifikimin dhe shfrytëzimin e buxhetit, menaxhimin e subvencioneve, menaxhimin e Llogarive të Arkëtueshme (LLA) dhe procedurat e prokurimit dhe faturimit apo pagesave për mallra dhe shërbime dhe investime kapitale.

## ME QËLLIM TË PËRMIRËSIMIT TË PRAKTIKAVE AKTUALE, KOALICIONI I OJQ-VE REKOMANDON:

- Kryetarët e Komunave (Zyrtarët Kryesorë Administrativ) të zbatojnë ligjin<sup>28</sup> për menaxhimin e financave publike dhe përgjegjësitë, respektivisht të ndërmarr masa disiplinore<sup>29</sup>, deri te shkarkimi<sup>30</sup>, për dështimet sistematike të konstatuara nga Auditori i Përgjithshëm, konform ligjeve në fuqi.<sup>31</sup>
- Ministria e Administrimit së Pushtetit Lokal të rris presionin tek ZKA-të për zbatimin e ligjit<sup>32</sup> për menaxhimin e financave publike dhe përgjegjësitë, respektivisht të ndërmarr masa disiplinore, deri te shkarkimi, për dështimet sistematike të konstatuara nga Auditori i Përgjithshëm.
- Ministria e Administrimit së Pushtetit Lokal të vendos ndarjen e granteve në bazë të performancës dhe menaxhimit financiar që konstaton raporti i Auditorit.

28 Ligji Nr. 04/L-194 për ndryshimin dhe plotësimin e ligjit nr. 03/L-048 për menaxhimin e financave publike dhe përgjegjësitë, të ndryshuar dhe plotësuar me ligjet nr. 03/L-221 dhe nr. 04/L-116, Neni 9, i cili riformulon nenin 14 të ligjit bazë, respektivisht paragrafin 14.7

29 Rregullore nr. 04/2011 për procedurat disiplinore në shërbimin civil

30 Rregullore nr. 01/2011 për ndërprerjen, pezullimin dhe përfundimin e marrëdhënies së punës në shërbimin civil

31 Ligji nr. 03/L-149 për shërbimin civil të republikës së kosovës, Kreu VIII

32 Ligji Nr. 04/L-194 për ndryshimin dhe plotësimin e ligjit nr. 03/L-048 për menaxhimin e financave publike dhe përgjegjësitë, të ndryshuar dhe plotësuar





- Komisioni Rregullativ i Prokurimit Publik duhet të inicioj procedurat për identifikimin e shkaktarëve dhe ndryshimet ligjore për të adresuar dhe akomoduar një përmirësim të sistemit aktual të prokurimit, dhe të inicioj ndryshim/plotësimin e legjislacionit aktual për të adresuar problemet sistematike lidhur me planifikimin e prokurimeve, ndarjen e prokurimeve në vlera minimale, menaxhimin e kontratave.
- Ministria e Financave të rishikoj politikat aktuale me qëllim të parandalimit të hyrjes në obligime pa zotim të mjeteve.
- Ministria e Financave të rishikoj politikat aktuale me qëllim të përmirësimit të situatës me pagesat e pa mbështetura dhe humbjen e parasë publike si pasojë e vonesave në përmbushjen e obligimeve dhe ekzekutimet përmes procedurave përmbarese.
- Të fuqizohet roli i NjAB brenda OB dhe nga menaxhmenti të kërkohet llogaridhënie kundrejt rekomandimeve të lëshuara nga NjAB duke përgatitur planet e veprimit me kohë dhe duke ju përmbajtur afateve kohore për zbatimin e këtyre planeve të veprimit.
- Në kuadër të sigurimit të kontrollit, në fushat e identifikuar si problematike, të rritet angazhimi i Njësisë së Auditimit të Brendshëm me qëllim të identifikimit dhe parandalimit të shkeljeve të mundshme, si dhe të rritet niveli i inspektimeve përcjellëse dhe adresuar këto rekomandime në një kohë sa më të shpejtë.



Janë një numër i gjetjeve të cilat përsëriten nga viti në vit në raportet e Zyrës Kombëtare të Auditimit (ZKA). Të njëjtat janë evidentuar edhe në raportet që mbulojnë vitin 2017, në komunat përkatëse.


---

me ligjet nr. 03/L-221 dhe nr. 04/L-116, Neni 9, i cili riformulon nenin 14 të ligjit bazë, respektivisht paragrafin 14.7





# KOMUNA E PRIZRENIT



Opinionimi i Auditorit për Komunën e Prizrenit për vitin 2017 është i pamodifikuar me theksim të çështjes.”

RAPORTI I AUDITIMIT PËR PASQYRAT FINANCIAR VJETORE TË KOMUNËS SË PRIZRENIT PËR VITIN E PËRFUNDUAR MË 31 DHJETOR 2017





### 3 Krahاسimi i çështjeve 2015-2017

Sipas Raportit të Auditorit të Përgjithshëm për vitin 2017 janë ngritur 20 çështje prej të cilave disa ishin çështje të përsëritura dhe ishin bartur nga viti në vit. Në vitin 2016, ishin evidentuar 16 çështje, dhe në vitin 2015 ishin ngritur 19 çështje. Çështjet të përsëritura janë si në vijim : Mos zbatimi i rekomandimeve nga viti paraprak , dobësi në kontrollet menaxheriale dhe menaxhimin e rrezikut, planifikim dhe menaxhim i dobët i kontratave, dobësi sistematike në prokurim, realizimin e pagesave, dobësi në regjistrimin e pasurisë nën 1,000€- E-pasuria, adresimi i rekomandimeve nga viti paraprak.

## Çështjet e identifikuara nga ZAK-ja 2015-2017 për Komunën e Prizrenit

	2017	2016	2015
1	Niveli i ulët i realizimit të buxhetit	Zbatimi i rekomandimeve nga viti paraprak – Prioritet i lartë	Implementimi i rekomandimeve nga viti paraprak
2	Menaxhim jo adekuat i të hyrave nga tatimi në pronë	Pyetëtori i vet-vlerësimit	Lista kontrolluese e vetëvlerësimit
3	Parregullsi në dhënien me qira të pronave komunale	Mungesa e Planit strategjike zhvillimor	Moszbatimi i kërkesave për menaxhimin e rrezikut
4	Parregullsi në kalkulimin e të hyrave për tatimin në prone dhe të hyrave tjera	Dobësi në kontrollet menaxheriale	Dobësi në Kontrollet Menaxheriale
5	Mungesë e dosjeve të personelit	Adresim i dobët i rekomandimeve NJAB	Mungesa e Planit Strategjik
6	Mungesë e dëshmimeve për punët jashtë orarit	Realizimi i buxhetit	Mosimplementimi i rekomandimeve NJAB
7	Parregullsi në angazhimin e stafit për shërbime të veçanta	Tatimit në pronë	Realizimi i Buxhetit
8	Pagesa për mallra dhe shërbime pa procedura të prokurimit	Të hyrat nga dhënia me qira e pronës komunale	Dobësi Sistematike në Prokurim





## Çështjet e identifikuara nga ZAK-ja 2015-2017 për Komunën e Prizrenit

			
9	Dobësi sistematike në menaxhimin e kontratave për investime kapitale	Nënshkrimi i kontratës pa procedura të prokurimit	Pagesa pa bazë të qartë ligjore
10	Pagesat e gjobave i pasojë vonesave në kryerjen e obligimeve	Kontrata me çmime për njësi dhe mungesa e projekteve ekzekutive	Pagesa pa procedura të prokurimit
11	Planifikim dhe menaxhim i dobët i kontratave	Inventarizimi dhe vlerësimi i pasurisë jo në pajtim me rregulloren	Kontratat për shërbime të veqanta
12	Shmangie nga procedurat e rregullta të prokurimit	Mosfunksionimi i sistemit të E-Pasurisë	Monitorimi i dobët dhe mungesa e raportimeve financiare
13	Dobësi në regjistrimin e pasurisë nën 1,000€- E-pasuria	Mungesa e procedurave të brendshme për menaxhimin e pasurisë	Mangësi në raportim, planifikim dhe faturim të të hyrave
14	Depozitimi i vonuar i parasë së arkëtuar	Rritja e vazhdueshme e llogarive të arkëtueshme dhe mungesa e masave përmbledhjen e tyre	Të hyrat nga sektori i mbeturinave
15	Rritja e të arkëtueshmeve	Mos raportimi i obligimeve në pajtim me kërkesat ligjore	Dobësi në kontratat e koncesioneve dhe qiradhënies
16	Niveli i lartë i obligimeve dhe rritja e detyrimeve kontingjente		Fituesi i ofertës për shfrytëzimin e lokaleve afariste me çmim me të ulët
17	Nivel i ulët i zbatimit të rekomandimeve nga viti paraprak dhe viti i mëhershëm		Mos regjistrim dhe mirëmbajtje të pasurisë
18	Nivel i ulët i zbatimit të rekomandimeve të NJAB-së		Mungesa e masave konkrete për mbledhjen e borxheve
19	Dobësi në kontrollet menaxheriale dhe menaxhimin e rreziku		Niveli i lartë i obligimeve dhe rritja e detyrimeve kontingjente





## 4 Problemet sistematike

Gjatë periudhës 2015-2017, raportet e auditorit reflektojnë dobësi sistematike në menaxhimin e kontratave për investime kapitale, lidhjen e kontratave publike jashtë planit vjetor të prokurimit në kundërshtim me Ligjin e Prokurimit Publik dhe si rezultat i planifikimit jo të saktë të projekteve ka shkaktuar kosto shtesë dhe krijuar sfida buxhetore për komunën dhe realizimi i projekteve jashtë planit mund të rrezikojë realizimin e projekteve të planifikuara dhe arritjen e objektivave të përcaktuara. Përpos detyrimeve të rregullta, komuna përballat edhe me detyrime kontingjente, të cilat në fund të vitit 2017 kanë arritur vlerën prej 1,225,000€.

## 5 Përmbledhje

Komuna e Prizrenit ballafaqohet me probleme të ndryshme për sa i përket menaxhimit të parasë dhe sigurimin e efikasitetit dhe ekonomicitetit të këtyre shpenzimeve. Raportet e Auditorit shpërfaqin sfida që nga planifikimi, realizimi i buxhetit, procedurat tenderuese, menaxhimi i kontratave, pagesat, inkasimin e të hyrave, regjistrat e pronave, dhe deri te evidencat e orëve të punës. Për shumicën e aktiviteteve komunale ka një komunikim dhe raportim të mirë mes bartësve të njësive dhe kryetarit, të përcjella me procesverbale, por mungon monitorimi strategjik, si dhe nuk ka një raportim formal dhe sistematik (monitorim) që i ndërlihd objektivat e komunës me rezultatet. Komuna edhe pse kishte formuar ekipin për hartimin e planit strategjik edhe me tej nuk e kishte hartuar planin strategjik dhe nuk kishte hartuar listën e rreziqeve me të cilën mund të ballafaqohet.

## 6

### Rekomandime


Duke u bazuar në raportet e ZKA për vitin 2017, dhe me qëllim të një raporti më pozitiv vitin në vijim, ne rekomandojmë që:

1. Kryetari i Komunës të fuqizoj sa më shumë Njësinë e Brendshme të Auditimit, me qëllim të rritjes së kontrollit të brendshëm
2. Njësia e Brendshme e Auditimit të auditoj periodikisht në statusin e adresimit të rekomandimeve të auditorit, si dhe të realizoj auditime ad-hoc në aktivitetet e identifikuara si problematike.
3. Kryetari i Komunës t'i kushtoj rëndësi strategjive dhe mekanizmave menaxhues për të rritur kualitetin e planifikimeve.





# KOMUNA E SUHAREKËS



“Opinionit i Auditorit për Komunën e Suharekës për vitin 2017 është i kualifikuar me theksim të çështjes.”

RAPORTI I AUDITIMIT PËR PASQYRAT FINANCIAR  
VJETORE TË KOMUNËS SË SUHAREKËS PËR VITIN E  
PËRFUNDUAR MË 31 DHJETOR 2017



## 1 Opinioni i Auditorit<sup>40</sup>

Pasqyrat Financiare Vjetore për vitin 2017 paraqesin një pamje të drejtë dhe të vërtetë në të gjitha aspektet materiale, më përjashtim të keq-klasifikimit të shpenzimeve për pagat përcjellëse të mësimdhënësve me rastin e pensionimit në vlerë 154,679€, të cilat, përmes vendimeve gjyqësore janë ekzekutuar dhe raportuar nga investimet kapitale dhe mallrat dhe shërbimet. Shpenzimet për mallra dhe shërbime në vlerë 482,818€, ishin buxhetuar dhe realizuar gabimisht nga kategoria e investimeve kapitale dhe Pasuritë jo kapitale (me vlerë nën 1,000€) të shpalo-sura në pasqyra si dhe detyrimet kontingjente nuk ishin të sakta dhe të plota.

## 2 Çështjet e identifikuara nga Auditori

**a. Planifikimi dhe realizimi i buxhetit** - Edhe pse në vitin 2017, Komuna e Suharekës kishte shpenzuar 93% të buxhetit final, realizimi i buxhetit mbetet në nivel jo të kënaqshëm si pasojë e realizimit të ulët të buxhetit për investime kapitale (85%), dhe mangësive në verifikimin e pronave tatimore, parregullsive në menaxhimin e të hyrave nga tatimi në pronë, si dhe gabimet në kalkulimin e taksës për biznese.

**b. Mallrat dhe shërbimet si dhe shërbimet komunale:** Buxheti final për mallra dhe shërbime (përfshirë komunalitet) në vitin 2017 është 1,395,200€. Prej tyre, ishin shpenzuar 1,239,825€ apo 89% e buxhetit. Sipas raportit vjetor të kontratave, janë nënshkruar 52 kontrata për furnizime dhe shërbime në vlerë prej 1,075,112€. Janë zhvilluar edhe 29 procedura me vlera minimale në vlerë prej 22,546€. Sipas raportit të au-

ditorit është ngritur vetëm një çështje në kategorinë e mallrave dhe shërbimeve, lidhur me ndarjen e detyrave, pe ç' rast te procedura e prokurimit "Furnizim me dru dhe pelet – Lot 2", menaxher i kontratës, është caktuar i njëjti zyrtari i cili ishte edhe anëtar i komisionit të vlerësimit të tenderit, e që bie në kundërshtim me dispozitat ligjore të Ligjit për Prokurim Publik<sup>41</sup>

**c. Investimet Kapitale:** Buxheti final për investimet kapitale në vitin 2017 ishte 4,908,385€. Prej tyre, ishin shpenzuar 4,167,361€ apo 85% e buxhetit. Ato kanë të bëjnë me ndërtimin e rrugëve lokale që marrin pjesë me 39% në total të shpenzimit pastaj investimet në vijim me 13%, mirëmbajtje investive 6% dhe zërat tjerë. Raporti i Auditorit shpërfaq vetëm një shqetësim lidhur me mos përmbushjen e kërkesave të dosjes së tenderit (kriteri profesional)<sup>42</sup>.

**d. Çështjet e përbashkëta për mallrat dhe shërbimet si dhe investimet kapitale-** Problemet e përbashkëta të identifikuara nga auditori në këto kategori janë, vlefshmëria e sigurisë së ekzekutimit të pamjaftueshme (për tri kontrata siguria e ekzekutimit nuk mbulonte edhe periudhën 30 ditore nga përfundimi i saj<sup>43</sup>), menaxhim jo i duhur i pasurisë<sup>44</sup>, dhe Shfrytëzimi i pronës komunale me kontrata të skaduar<sup>45</sup>.

40 Raporti i auditimit për pasqyrat financiar vjetore të komunës së Suharekës për vitin e përfunduar më 31 dhjetor 2017

41 Neni 62.3 pika 7, të Rregullat dhe Udhëzuesi Operativ i Prokurimit Publik, përkatësisht neni 81 i ligjit të prokurimit nr. 04/L-042 i ndryshuar dhe plotësuar me Lgjin Nr. 04/L-237, Ligjin Nr. 05/L-068 dhe Ligjin Nr. 05/L-092.

42 Te procedura e prokurimit "Sanimi dhe mirëmbajtja e rrugëve lokale" kishte vendosur kriterin profesional për sigurimin e një inxhinier të bazuar në njoftim për kontratë, ndërsa OE fitues ka sjellë vetëm bachelor i ndërtimtarisë.

43 "Furnizim me dru dhe pelet – Lot 2"; "Sanimi dhe mirëmbajtja e rrugëve lokale" dhe "Ndërtimi i qendrës turistike në fshatin Mushtisht – Amfiteater". Sipas neni 30.6, të - RRUOPP, siguria e ekzekutimit do të mbetet e vlefshme për një periudhë prej 30 ditësh pas kompletimit të kontratës.

44 Komuna nuk ka kryer inventarizimin e pasurisë jo financiare për vitin 2017 bazuar në Rregulloren për menaxhimin e pasurisë jo financiare - Nr. 02/2013

45 Në pesë raste e trajtuara nga Auditori, kishin skaduar kontratat për dhënie të pronës komunale në shfrytëzim/me qira.







### 3 Krahاسimi i çështjeve 2015-2017

According to the Auditor's Report, the NAO has highlighted 14 issues for 2017, while in 2016 there were 10 issues raised, and in 2015 a total of 13 issues, and it is worth mentioning that in terms of municipal financial activity governance there are still areas where important actions are necessary. The following table reflects the recommendations of the NAO for the period 2015-2017.

## Çështjet e identifikuara nga ZAK-ja 2015-2017 për Komunën e Suharekës

	2017	2016	2015
1	Dobësitë në kontrole për ta konfirmuar klasifikimin e duhur të shpenzimeve	Zbatimi i rekomandimeve nga viti paraprak	Implementimi i rekomandimeve nga viti paraprak
2	Realizimi i ulët i buxhetit për investime kapitale	Pyetësori i vet-vlerësimit	Lista kontrolluese e vetëvlerësimit
3	Mangësi në verifikimin e ponave tatimore	Dokumentet strategjike	Moszbatimi i kërkesave për menaxhimin e rrezikut
4	Parregullsi në kalkulimin e të hyrave për tatimin në prone dhe të hyrave tjera	Zbatimi i rekomandimeve nga NJAB	Dobësi në Kontrolllet Menaxheriale
5	Gabime në kalkulim të taksës për bizneset	Dobësi në ekzekutimin e buxhetit dhe shpenzim i ultë i të hyrave vetjake	Mosimplementimi i rekomandimeve NJAB



## Çështjet e identifikuara nga ZAK-ja 2015-2017 për Komunën e Suharekës

2017

2016

2015

6	Dobësi në procesin e rekrutimit për stafin shëndetësor	Tatimit në pronë	Dobësitë në blerjet përmes prokurimit
7	Ndarje jo e duhur e detyrave	Kontrolle të dobëta në qiradhëniet komunale	Marrëveshje bashkëpunimi dhe bashkëfinancimi me OJQ në kundërshtim me rregulloret në fuqi
8	Mos përmbushje e kërkesave të dosjes së tenderit (kriteri profesional)	Dosjet e mësimdhënësve	Shpenzimet për udhëtime jo sipas Ligjit dhe Udhëzimeve Administrative
9	Vlefshmëria e sigurisë së ekzekutimit e pamjaftueshme	Menaxhimi i pasurive përmes softuerit E-pasuria	Parregullsi në rekrutimin e personelit
10	Menaxhim jo i duhur i pasurisë	Trajtimi i llogarive të arkëtueshme	Kritere të mangëta të Rregullores dhe mungesë raportimi nga përfituesit e subvencioneve



## 4 Problemet sistematike

Si probleme sistematike me te cilat ballafaqohet komuna e Suharekës sipas raporteve të auditorit të ZKA-së janë: Parregullsi në kalkulimin e të hyrave për tatimin në prone dhe të hyrave tjera; Menaxhim jo i duhur i pasurisë; Realizimi i ulët i buxhetit për investime kapitale. Pasqyra e detyrimeve të papaguara ndaj furnitorëve në fund të vitit 2017 ishte 63,355€. Këto detyrime janë bartur për t'u paguar në vitin 2018. Detyrimet e papaguara janë zvogëluar për 38% krahasuar me periudhën e njëjtë të vitit të kaluar.

## 5 Përmbledhje

Edhe pse komuna e Suharekës qëndron mirë për sa i përket realizimit të buxhetit, raporti i ZKA për vitin 2017 shpërfaq disa sfida lidhur me llogaridhënien, menaxhimin e rrezikut dhe cilësinë e raportimit menaxherial. Përgjigja efektive ndaj rekomandimeve të auditimit dhe mungesa e një roli aktiv të komitetit të auditimit nuk janë të vendosura.

## 6

### Rekomandime

1. Kryetari duhet të angazhohet në adresimin efektiv të zbatimit të rekomandimeve të auditimit të jashtëm, si dhe zbatimi i rekomandimeve të auditimit të brendshëm janë disa nga fushat të cilat komuna duhet dhënë prioritet sa i përket një qeverisjeje më efektive.





# KOMUNA E FERIZAJT



“Opinioni i Auditorit për Komunën e Ferizajt për vitin 2017 është i kualifikuar me theksim të çështjes.”

RAPORTI I AUDITIMIT PËR PASQYRAT FINANCIAR VJETORE TË KOMUNËS SË FERIZAJ PËR VITIN E PËRFUNDUAR MË 31 DHJETOR 2017

## 1 Opinioni i Auditorit<sup>46</sup>

Pasqyrat Financiare Vjetore 2017, paraqesin një pamje të drejtë dhe të vërtetë në të gjitha aspektet materiale, përveç keq-klasifikimit të shpenzimeve në vlerë 434,732€, të cilat për nga natyra i takonin mallrave dhe shërbimeve. Theksimi i çështjes ka të bëjë me pagesat për investime kapitale të bëra përmes vendimeve të gjykatave apo përmbarueseve në vlerë 690,292€, e të cilat nuk ishin regjistruar në regjistrin e pasurive. Në këtë regjister janë përfshirë edhe banesat në pronësi të komunës, të cilat ishin dhënë me qira. Me tutje në raport thuhet se, Llogaritë e Arkëtueshme për lejet e ndërtimit në vlerë 446,279€ nuk ishin shpalosur saktë në pasqyrat financiare.

## 2 Çështjet e identifikuar nga Auditori

- a. Planifikimi dhe realizimi i buxhetit** - Sipas raportit të Auditorit për vitin 2017 Komuna e Ferizajt ka shpenzuar 95% të buxhetit final ose 27,058,456€. Disa nga problemet e identifikuar në kategorinë e buxhetit kanë të bëjnë me lëshimine vendimeve për leje të ndërtimit pa përfunduar pagesa e plotë e taksave, mos kryerja e obligimeve (qirasë) nga shfrytëzuesit e pronës komunale dhe mos kryerja e obligimeve (taksës) nga bizneset dhe punësimi i 40 mësimdhënësve pa konkurs (shpallje publike).

- b. Mallrat dhe shërbimet si dhe shërbimet komunale** - janë dy çështje të ngritura nga ZKA lidhur me shpenzimet në mallra dhe shërbime e të cilat janë pranimi i mallrave pa komision<sup>47</sup> dhe mungesa e raportit për shërbimet e kryera dhe mos ndalja e tatimit.<sup>48</sup>
- c. Investimet Kapitale** - Tek investimet kapitale raporti i ZKA thekson tri çështje të identifikuar, të cilat janë: tejkalim i vlerës së kontratës në raport me kornizën buxhetore për projekte<sup>49</sup>, pagesa e faturave duke e shfrytëzuar buxhetin e projekteve tjera<sup>50</sup>, dhe pagesë jashtë llogarisë së operatorit kontraktues.
- d. Çështjet e përbashkëta për mallrat dhe shërbimet si dhe investimet kapitale** - Këtu kemi dy çështje dhe ato janë: dobësi në menaxhimin e kontratave<sup>51</sup> dhe mos përdorimi i E-pasurisë dhe mungesa e depoz<sup>52</sup>.

46 Raporti i auditimit për pasqyrat financiar vjetore të komunës së Ferizajt për vitin e përfunduar më 31 dhjetor 2017

47 Furnizimi më lëndë djegëse dru "Ahu" në vlerë 8,055€

48 Gjatë testimit të tri kontratave për shërbime të veçanta, në vlerë totale 2,071€, komuna nuk kishte të bashkangjitur raport (dëshmi) për punët e kryera, të arsyetuara nga mbikëqyrësi i drejtpërdrejtë.

49 Në kontratës për ndërtimin e shkollës së mesme në Ferizaj, kontratë tri vjeçare, nr. 175 e dt.20.11.2017 në vlerë 1,803,727€, nuk ishte respektuar korniza buxhetore për projekte kapitale. Sipas kornizës buxhetore për projekte kapitale vlera e përcaktuar për këtë projekt për tri vite ishte 570,000€, me diferencë 1,233,726€.

50 Në dy projekte ZKA kishte identifikuar kryerjen e obligimeve kanë shfrytëzuar mjetet nga projektet tjera pa ndonjë vendim nga Kuvendi Komunal për aprovimin e ndryshimeve në buxhet.

51 Në katër projekte kapitale, ZKA- ja ka vërejtur se komuna nuk kishte përgatitur një plan për menaxhimin e kontratave. Gjithashtu, te kontrata për mirëmbajtjen e ngrohjes qendrore të shkollave të Komunës së Ferizajt ka identifikuar se nuk ishte caktuar organi mbikëqyrës i punimeve.

52 Komuna e Ferizajt nuk e përdorë sistemin "e-pasuria" për t'i regjistruar pasuritë jo financiare nën 1,000€ dhe stoqet.



### 3 Krahاسimi i çështjeve 2015-2017

Në raportin e auditorit për vitin 2017 kemi 17 çështje të ngritura nga të cilat 7 të përsëritura nga vitet paraprake, në vitin 2016 ka pasur 29 çështje te evidentuara, ndërsa në vitin 2015 në Komunën e Ferizajt ka pasur 20 çështje te evidentuara në raport të auditimit.

## Çështjet e identifikuara nga ZAK-ja 2015-2017 për Komunën e Ferizajt

	2017	2016	2015
1	Lëshimi i vendimeve për leje të ndërtimit pa përfunduar pagesa e plotë e taksave	Zbatimi i rekomandimeve nga viti paraprak	Implementimi i rekomandimeve nga viti paraprak
2	Mos kryerja e obligimeve (qirasë) nga shfrytëzuesit e pronës komunale	Pyetësori i vet-vlerësimit	Lista kontrolluese e vetëvlerësimit
3	Mos kryerja e obligimeve (taksës) nga bizneset	Planet strategjike	Moszbatimi i kërkesave për menaxhimin e rrezikut
4	Punësimi i 40 mësimdhënësve pa konkurs (shpallje publike)	Dobësi në kontrollet menaxheriale	Dobësi në Kontrollet Menaxheriale
5	Pranimi i mallrave pa komision	NJAB dhe komiteti i auditimit	Auditimi i Brendshëm dhe Komiteti i Auditimit
6	Mungesa e raportit për shërbimet e kryera dhe mos ndalja e tatimit	Realizimi i buxhetit	Realizimi i buxhetit
7	Tejkalim i vlerës së kontratës në raport me kornizën buxhetore për projekte	Mos regjistrimi i tatimit në pronë	Dobësi sistematike në prokurim
8	Pagesa e faturave duke e shfrytëzuar buxhetin e projekteve tjera	Mos aplikimi i interesit për taksë në firmë	Shmangie nga procedurat e prokurimit



## Çështjet e identifikuara nga ZAK-ja 2015-2017 për Komunën e Ferizajt

2017

2016

2015

9	Pagesë jashtë llogarisë së operatorit kontraktues	Mungesa e plotësimit të formularit për leje ndërtimi	Urdhër blerjet pas pranimit të faturave
10	Dobësi në menaxhimin e kontratave	Mangësi në evidencë për të hyrat nga kadastri	Mungesë e përshkrimit të shpenzimeve
11	Mos përdorimi i E-pasurisë dhe mungesa e depos	Mos arkëtimi i qirasë nga prona publike	Planifikim i dobët i shërbimeve të pastrimit
12	Rritja e vazhdueshme e të arkëtueshmeve të pa mbledhura	Vonesa në evidentim në listën e pagave dhe mangësi tjera	Pagesat sipas marrëveshjeve për bashkëfinancim
13	Mungesa e dokumentacionit të obligimeve të pa paguara	Paradhënie për komunal	Dreka zyrtare
14	Nivel i ulët i zbatimit të rekomandimeve nga vitet paraprake	Furnizimi me material zyre kryesisht me çmime të larta	Shërbimet e veçanta
15	Nivel i ulët i zbatimit të rekomandimeve të auditimit të brendshëm	Shpenzime për shërbime të veçanta	Dobësi sistematike në procesin e pagesave
16	Dobësi në kontrollet menaxheriale dhe menaxhimin e rrezikut	Mospërputhje në raporte për mirëmbajtjen e rrugëve të komunës	Dobësi në ndarjen e subvencioneve
17		Mungesa e raporteve për shpenzime të naftës	Të hyrat nga tatimi në pronë, qiratë dhe taksat e biznesit
18		Shpenzimet e reprezentacionit	Mos regjistrimi i plotë i pasurive
19		Pagesa nga kodi i gabuar	Kontrolle jo adekuate për mbledhjen e LL/A



## Çështjet e identifikuara nga ZAK-ja 2015-2017 për Komunën e Ferizajt

	2017	2016	2015
20		Sigurimi i tenderit jo sipas kushteve të kontratës	Hyrja në obligime përtej ndarjeve buxhetore
21		Tërheqja e sigurimit të tenderit	
22		Pagesë jashtë llogarisë së operatorit kontraktues	
23		Ndryshimi i mëvonshëm i kërkesave për aftësi ekonomike dhe teknike	
24		Pagesa për financim të bizneseve	
25		Pagesat sipas marrëveshjeve për bashkëfinancim	
26		Mos përdorimi i E-pasurisë dhe mungesa e deposë	
27		Rritja e vazhdueshme e borxheve të pa mbledhura	
28		Menaxhim i dobët i detyrimeve	

## 4 Problemet sistematike

Si probleme sistematike me të cilat përballet Komuna e Ferizajit sipas raporteve të auditimit nga ZKAjanë: mos përdorimi i E-pasurisë dhe mungesa e depos, dobësi në menaxhimin e kontratave. Raporti i ZKA pasqyron se Komuna nuk ka arritur të krijojë një sistem efektiv për mbledhjen e të hyrave të saj. Si rezultat po sfidohet me rritjen e vazhdueshme të llogarive të arkëtueshme të cilat në fund të vitit 2017 ishin 8,060,640€. Gjithashtu, nga 58 mostrat e testuara nga raporti i obligimeve të papaguara, në pesë prej tyre komuna nuk ka mundur të sigurojë dokumentacionin e nevojshëm për auditim. Vlera totale e tyre ishte 125,000€. Mos ofrimi i dokumenteve për auditim paraqet kufizim në fushëveprim.

## 5 Përmbledhje


Ekziston një numër i dobësive të qeverisjes brenda komunës veçanërisht në lidhje me llogaridhënien, menaxhimin e rrezikut dhe cilësinë e raportimit menaxherial. Përgjigja efektive ndaj rekomandimeve të auditimit dhe operimi i një sistemi cilësor të auditimit të brendshëm në lidhje me zbatimin e rekomandimit, nuk janë të vendosura. Nuk ka raporte cilësore të përgatitura nga prokurimi në lidhje me realizimin e kontratave të nënshkruara dhe krahasimin e tyre me planifikim të prokurimit. Mungesa e raporteve për menaxhmentin nga zyra ligjore për detyrimet kontingjente. Menaxhimi financiar dhe kontrolli ka dëshmuar proces jo të mirë të rishikimit dhe siguri në zbatimin e legjislacionit dhe proceseve të tjera të kontrollit. Komuna në vazhdimësi ka përsëritje të çështjeve sistematike të ngritura nga auditorët nga ZKA që nga viti 2015, si nivel i ulët i zbatimit të rekomandimeve nga vitet paraprake. Dobësi në kontrollet menaxheriale dhe menaxhimin e rrezikut, mos kryerja e obligimeve (qirasë) nga shfrytëzuesit e pronës komunale, mos kryerja e obligimeve (taksës) nga bizneset, mos përdorimi i E-pasurisë dhe mungesa e depos.

## 6

## Rekomandime

1. Kryetari duhet t'i analizojë arsyet për Kualifikim të opinionit dhe Theksim të çështjes në 2017 dhe t'i identifikoj veprimet që kërkohen për të mundësuar që shpenzimet klasifikohen në kategoritë adekuate si dhe e gjithë pasuria evidentohet në regjistrat kontabël.
2. Kryetari duhet të kryejë një rishikim të procesit të prokurimit dhe menaxhimit financiar dhe kontrollit për t'i identifikuar arsyet për paraqitjen e dobësive si dhe të përcaktoj veprimet e nevojshme për t'i adresuar ato.
3. Kryetari duhet ta zbatoj një proces rigoroz për të siguruar që procesi i zbatimit të rekomandimeve të vitit paraprak adresohen në mënyrë aktive ku çështjet/ progresit kyçe i raportohen menaxhmentit në baza mujore.
4. Kryetari duhet të sigurojë që aranzhimet e qeverisjes janë rishikuar në mënyrë kritike për t'u siguruar se janë bërë ndryshime adekuate në përmirësimin e aranzhimeve të llogaridhënies dhe raportimit menaxherial për ta ngritur efektivitetin operativ (shih çështjet 16 -17).

# KOMUNA E LIPJANIT



“Opinionit i Auditorit për  
Komunën e Lipjanit  
për vitin 2017 është i  
pamodifikuar.”

RAPORTI I AUDITIMIT PËR PASQYRAT FINANCIAR  
VJETORE TË KOMUNËS SË LIPJANIT PËR VITIN E  
PËRFUNDUAR MË 31 DHJETOR 2017



## 1 Opinioni i Auditorit<sup>53</sup>

Opinion i pamodifikuar, ku Pasqyrat Financiare Vjetore për vitin 2017 paraqesin një pamje të drejtë dhe të vërtetë në të gjitha aspektet materiale. Si çështje kyçe të auditimit përmendet fakti se në kuadër të prezantimit të LLA prej 3.9 milionë €, përfshihen edhe të arkëtueshmet e bartura prej më shumë se pesë vitesh (LLA për taksat për leje afariste në vlerë 0.5 milion €) ku mundësia e inkasimit të tyre është minimale. Gjithashtu duke u nisur nga fakti që të hyrat nga tatimi në pronë përbejnë rreth 45% të hyrave të komunës, LLA nga kjo kategori kanë shënuar rritje prej 15%, që rrezikon financimet e ardhshme nga të hyrat e kësaj kategorie. Me tutje, gjatë vitit 2017 dhe me parë komuna është paditur për shuma të konsiderueshme (mbi 600 mijë €) nga ana e operatorëve ekonomik por edhe qytetarëve. Nëse paditë gjyqësore vendosen në favor të operatorëve, OB pritet të ketë pasoja të rënda financiare. Komuna duhet t'i kushtojë rëndësi të veçantë trajtimit të detyrimeve kontingjente sidomos për njohjen dhe matjen e tyre.

## 2 Çështjet e identifiкуara nga Auditori

- Planifikimi dhe realizimi i buxhetit:** Edhe pse realizimi i buxhetit për vitin 2017 ka qenë i kënaqshëm (91%), tek planifikimi dhe realizimi i buxhetit ZKA në raportin e saj ka ngritur çështje të cilat kanë të bëjnë me realizimi i ultë i buxhetit për subvencione (77%) dhe investime kapitale (83%),

si pasojë e mungesës së analizave në baza të rregullta mujore mbi ecuritë buxhetore si dhe anulimit të projekteve si pasojë e vendimeve gjyqësore kryesisht për obligimet e pagave ndaj arsimtarëve të angazhuar në vitin 2013.

- Mallrat dhe shërbimet si dhe shërbimet komunale:** Auditori ka ngritur çështjen e dobësive në procesin e prokurimit. Raporti i auditorit tregon se një numër i madh i prokurimeve të realizuara përmes procedurave me vlerë minimale për t'iu shmangur aplikimit të procedurave të hapura<sup>54</sup>. Te procedura e prokurimit "Furnizimi me dru për ngrohje për shkollat, QKMF-në dhe shtëpinë e kulturës me pelet" në vlerë 123,821€ njoftimi për nënshkrimin e kontratës është publikuar me datën 03.10.2017, ose 30 ditë pas nënshkrimit të kontratës (04.09.2017).; dhe Në dy raste deklarata e nevoja dhe përcaktimi i disponueshmërisë së fondeve, për prokurimet "Furnizime me ushqime për QEAP – Çerdhja Lipjan" dhe "Ditëve të shkollave" në vlerë 82,473€, janë nënshkruar nga zyrtaret përgjegjës 10 ditë pas raportit të vlerësimit të tenderit.
- Investimet Kapitale** - Tek kjo kategori buxhetore, Auditori kishe identifikuar dobësi në prokurim dhe menaxhim të kontratave, të cilat janë të lidhura me planifikim të dobët<sup>55</sup>, menaxhim të kontratave<sup>56</sup>, mos respektim i dispozitave ligjore lidhur me modifikimet e kontratave<sup>57</sup>, dhe probleme gjatë procesit të vlerësimit të tenderëve<sup>58</sup>.

53 Raporti i auditimit për pasqyrat financiar vjetore të komunës së Lipjanit për vitin e përfunduar më 31 dhjetor 2017

54 Komuna gjatë vitit 2017 ka lidhur 85 kontrata me vlerë minimale në vlerë totale 55,308€.

55 Prokurimi për projektin "Asfaltimi i rrugës nga Dobratini – Sillovi dhe Rrugës së Kuqe në fshatin Sillovi" në vlerë 14,755€, është realizuar jashtë planit të prokurimit, si dhe punët për asfaltimin e rrugëve janë kontraktuar në sezonin e dimrit që ka bërë të pamundshme realizimin e kësaj kontrate.

56 Te procedura e prokurimit "Ndërtimi i shkollës SHFMU - Neze Bujani - Bujan paralele e ndarë Bregu i Zi" me vendim dhe plan për menaxhimin e kontratës, organ mbikëqyrës është caktuar një zyrtar nga Departamenti Shërbimeve Publike, mirëpo raportet e mbikëqyrjes (situacionet e punëve të kryera) janë të nënshkruara nga dy zyrtarë tjerë nga ky sektor.

57 Në katër raste departamenti i prokurimit ka aprovuar kërkesat e menaxherëve të kontratës për zgjatje të afatit të punimeve. Po ashtu në katër raste tjera ka aprovuar ndryshime edhe në paramasë. Këto ndryshime, nuk janë kryer në përputhje me Udhëzuesin Operativ të Prokurimit sipas neni 61.23, ku kërkohet që vetëm Zyrtari Kryesor Administrativ, paraprisht të aprovoj këto ndryshime.

58 Në dy raste komuna ka shpall fitues Operatorin Ekonomik që nuk ka përmbushur kriteret e caktuara në dosjen e tenderit (kërkesat për kapacitetet teknike dhe profesionale). Te projekti "Ndërtimi i shkollës fillore, Neze Bujani - Bujan, paralele e ndarë Bregu i Zi" është kërkuar një inxhinier i arkitekturës, ndërsa Operatori ekonomik fitues ka sjellë diplomën bachelor i arkitekturës. Gjithashtu edhe tek prokurimi për "Ndërtimi i Zonës Ekonomike -Parku Industrial, në Qytagë - faza II" ishte kërkuar inxhinier i ndërtimtarisë ndërsa nga operatori fitues është sjellë vetëm diploma për përgatitjen bachelor i ndërtimtarisë.





- d. **Çështjet e përbashkëta për mallrat dhe shërbimet si dhe investimet kapitale** - Raporti i ZKA pasqyron dy çështje të përbashkëta ndërmjet këtyre aktiviteteve buxhetore, zotimin e mjeteve pas nënshkrimit të kontratës<sup>59</sup> dhe ndarje jo e duhur e detyrave në proceset e prokurimit.

### 3 Krahasimi i çështjeve 2015-2017

Raporti i auditimit për PFV-të e vitit 2016 të Komunës së Lipjanit ka rezultuar në 16 rekomandime. Deri në fund të auditimit për vitin 2017, gjashtë rekomandime janë zbatuar; katër janë në proces të zbatimit dhe gjashtë nuk janë zbatuar ende. Po ashtu, nga viti 2015 ishin bartur edhe 11 rekomandime (katër të pa zbatuara dhe shtatë të tjera ishin në zbatim e sipër). Këto rekomandime nuk janë zbatuar ende dhe disa prej tyre përsëritën edhe në vitin 2017.

## Çështjet e identifikuara nga ZKA-ja 2015-2017 për Komunën e Lipjanit

	2017	2016	2015
1	Realizimi i ultë i buxhetit për subvencione dhe investime kapitale	Zbatimi i rekomandimeve nga viti paraprak	– Implementimi i rekomandimeve nga viti paraprak
2	Keq klasifikim i shpenzimeve si pasojë e pagesave me vendim gjyqësorë	Pyetësori i vet-vlerësimit	Lista kontrolluese e vetëvlerësimit
3	Nivel i ulët i verifikimit të pronave të regjistruara	Dokumentet strategjike	Moszbatimi i kërkesave për Menaxhimin e rrezikut
4	Parregullsi në kalkulimin e të hyrave	Zbatimi i rekomandimeve të NjAB	Dobësi në Kontrollët Menaxheriale
5	Parregullsi në shqyrtimin e kërkesave për leje të ndërtimit dhe mjedisore	- Ekzekutimi i buxhetit për shpenzime kapitale	Funksionimi i NjAB-it dhe komitetit të auditimit
6	Dobësi në procesin e rekrutimit	Tatimi në pronë – Prioritet i lartë	Realizimi i buxhetit

59 "Ndërtimi i shkollës SHFMU - Nezë Bujani - Bujan, paralele e ndarë Bregu i Zi" në vlerë 148,392€, "Mirëmbajtja e rrugëve të asfaltuara në komunën e Lipjanit" në vlerë 115,707€; dhe "Furnizime me ushqime për QEAP – Çerdhja Lipjan dhe ditëve të shkollave"



## Çështjet e identifikuara nga ZKA-ja 2015-2017 për Komunën e Lipjanit

	2017	2016	2015
7	Dobësi në procesin e prokurimit	Kontrolle të dobëta në qiradhëniet komunale	Dobësi sistematike në prokurim
8	Dobësi në prokurim dhe menaxhim të kontratave	Mos aplikimi i drejtë i tarifave për lejet e ndërtimi	Dobësitë jo-sistematike të prokurimit
9	Zotimi i mjeteve pas nënshkrimit të kontratës	Ngarkesat joadekuate me tarifa dhe lëshimi i lejes para pagesës	Mungesa e dëshmimeve me rastin e përzgjedhjes së përfituesve
10	Ndarje jo e duhur e detyrave në proceset e prokurimit	Mos respektimi i rregullores për ndarjen e subvencioneve	Tatimi në pronë
11	Parregullsi në menaxhimin e tatimit në pronë	- Inicimi i prokurimeve për punë pa projekte	Të hyrat nga dhënia me qira e pronës komunale
12	Menaxhim jo i duhur i obligimeve	Pagesa për pozicione të pakompletuara	Të hyrat nga Lejet e Ndërtimit
13	Zbatimi i ultë i rekomandimeve nga viti paraprak dhe viti i mëhershëm	Kontratat pa zotim të mjeteve	Obligimet e papaguara
14	Dobësi në kontrollet menaxheriale dhe menaxhimin e rrezikut	Trajtimi i llogarive të arkëtueshme	
15		Obligimet e papaguara	



## 4 Problemet sistematike

Si probleme sistematike që përballet Komuna e Lipjanit sipas raporteve të auditimit nga ZKA-ja janë: Nivel i ulët i verifikimit të pronave të regjistruara, parregullsi në kalkulimin e të hyrave, parregullsi në menaxhimin e tatimit në pronë, hyrja në obligime kontraktuale në mungesë të zotimit të fondeve, dobësi në menaxhimin e kontratave si dhe probleme me obligime të papaguara.

## 5 Përmbledhje

Ekziston një numër i dobësive të qeverisjes brenda komunës së Lipjanit veçanërisht në lidhje me llogaridhënien, menaxhimin e rrezikut dhe cilësinë e raportimit menaxherial. Aranzhimet tjera të cilat do ta mbështesnin zhvillimin e qeverisjes, si përgjigja efektive ndaj rekomandimeve të auditimit, mbeten ende sfiduese për komunën. Gjithashtu në mesin e lëndëve që ishin subjekt i auditimit për 2017 ishin edhe dy fatura<sup>60</sup> të prezantuara në raportin e obligimeve të paguara, të cilat përkundër kërkesës të vazhdueshme të ZKA, nuk ju ishte ofruar qasje.

## 6

### Rekomandime

1. Kryetari duhet të sigurohet se procesi i përgatitjes së pasqyrave financiare 2018 përfshinë një rishikim përfundimtar të menaxhmentit përgjegjës, dhe deklarata për pasqyrat financiare nënshkruhet vetëm pasi të jenë zbatuar të gjitha veprimet e nevojshme.
2. Kryetari duhet ta zbatoj një proces rigoroz për të siguruar që rekomandimet e vitit paraprak adresohen në mënyrë aktive ku çështjet/progreset kyçe i raportohen menaxhmentit në baza mujore.
3. Kryetari, duhet të sigurojë që aranzhimet e qeverisjes janë rishikuar në mënyrë kritike dhe janë ndërmarrë veprimet e duhura për përmirësimin e aranzhimeve të llogaridhënies dhe raportimit menaxherial për të gjitha çështjet e identifikuar në këtë raport.

60 OE Standard Benz në vlerë 306€ dhe OE Ipko në vlerë 1,906€







# KOMUNA E PODUJEVËS



“Opinionit i Auditorit për Komunën e Podujevës për vitin 2017 është i kualifikuar me theksim të çështjes.”

RAPORTI I AUDITIMIT PËR PASQYRAT FINANCIAR VJETORE TË KOMUNËS SË PODUJEVËS PËR VITIN E PËRFUNDUAR MË 31 DHJETOR 2017







### 3 Krahasimi i çështjeve 2015-2017

Në raportin a auditorit për vitin 2017 kemi 22 çështje të ngritura nga të cilat 8 janë nga viti paraprak, sipas auditorit nga rekomandimet e dhëna për vitin 2016, tri rekomandime janë zbatuar; gjashtë ishin në proces dhe tetë nuk janë adresuar ende. Tabela në vijim pasqyron rekomandimet e ZKA për periudhën 2015-2016-2017.

## Çështjet e identifikuara nga ZAK-ja 2015-2017 për Komunën e Podujevës

	2017	2016	2015
1	Nivel i ulët i realizimit të buxhetit te investimet kapitale	Zbatimi i rekomandimeve nga viti paraprak	Implementimi i rekomandimeve nga viti paraprak
2	Pagesa direkt nga Thesari	Pyetësori i vet-vlerësimit	Lista kontrolluese e vetëvlerësimit
3	Mos efikasitet në mbledhjen e të hyrave	Dobësi në kontrollet menaxheriale	Moszbatimi i kërkesave për Menaxhimin e rrezikut
4	Ngecjet tek të hyrat nga qiraja	Funksionimi i NjAB dhe Komitetit të Auditimit	Dobësi në Kontrollet Menaxheriale
5	Mungesa e përditësimit të të dhënave nga tatimi në pronë	Realizimi i buxhetit	Funksionimi i NJAB-it dhe komitetit të auditimit
6	Kompensimi i pagave dhe buxhetimi i koeficienteve	Mangësi në rregulloren e të hyrave dhe jo në harmoni me UA	Realizimi i buxhetit
7	Marrëveshjet për shërbime të veçanta	Sfidat në menaxhimin e pronës komunale	Dobësi sistematike në prokurim
8	Mos plotësimi i pozitës së udhëheqësit të prokurimit	Dobësitë në Aktemërimet e karrierës, kompensimet e stafit dhe rekrutimit	Kontrata për shërbime të veçanta
9	Mangësi në procesin e pagesave	Kontratat për shërbime të veçanta	Mungesa e dëshmimeve me rastin e përzgjedhjes së përfutuesve
10	Ndarja e subvencioneve dhe transfereve	Dobësitë në menaxhimin e subvencioneve	Tatimi në pronë



## Çështjet e identifikuara nga ZAK-ja 2015-2017 për Komunën e Podujevës

2017

2016

2015

11	Realizimi i pagesave pa pranim të mallrave	Dobësi sistematike në prokurim	Të hyrat nga dhënia me qira e pronës komunale
12	Hyrje në kontrata pa mjete të buxhetuara	Pagesa direkte nga Thesari për investime kapitale	Të hyrat nga taksa në firmë
13	Mos ndarja e përgjegjësisë në mes të komisioneve	Mungesa e regjistrimit të plotë të pasurive dhe inventarizimit	Mungesa e regjistrimit të plotë të pasurive dhe mos pajtueshmëri me rregulloren e menaxhimit të pasurive
14	Ndarja e tenderëve dhe përdorimi i procedurave minimale	Borxhet nga dhënia me qira e pronës komunale - Prioritet i lartë	Mungesa e një protokolli për evidentimin e faturave
15	Vonesat në realizimin e projekteve kapitale	Borxhet nga taksa në Biznese	
16	Dobësi në menaxhimin dhe raportimin e pasurisë	Raportimi i obligimeve	
17	Mungesa e masave konkrete për mbledhjen e borxheve		
18	Evidentimi dhe raportimi i obligimeve		
19	Nivel i ulët i zbatimit të rekomandimeve nga viti paraprak dhe viti i mëhershëm		
20	Funksionimi i NjAB-së		
21	Dobësi në kontrollet menaxheriale dhe menaxhimin e rrezikut		



## 4 Problemët sistematike

Sipas raporteve të ZKA problemet më të cilat ballafaqohet komuna e Podujevës janë: niveli i ulët i ekzekutimit të buxhetit, dobësia në kontrollet menaxheriale, niveli i ulët i zbatimit të rekomandimeve, mangësi në lidhje me operacionet e NjAB-së, mos kryerja e obligimeve nga shfrytëzuesit e pronave të komunës (qiramarrësit), mungesa e masave konkrete për mbledhjen e borxheve, dobësitë në raportimin e obligimeve, mos verifikimi i 1/3 të pronave komunale .

## 5 Përmbledhje

Ekzistojnë disa mangësi sa i përket qeverisjes brenda komunës, veçanërisht në lidhje me mos zbatimin e plotë të rekomandimeve nga viti paraprak, realizimin e buxhetit dhe kontratat e nënshkruara, dhe iniciativa modeste për mbledhjen e të hyrave.

Sipas Ligjit për planifikimin hapësinor planifikimi i nivelit lokal bëhet përmes tri dokumenteve: Plani Zhvillimor Komunal; Harta Zonale e Komunës; dhe planet Rregulluese të Hollësishe. Komuna gjatë vitit 2017 kishte Planin Zhvillimor Komunal 2016-2025 i njëjti kishte të llogaritur koston për zbatimin e tij dhe afati për arritje të objektivave. Vlerësimi i kësaj strategjie ishte bërë vetëm në mënyrë joformale. Po ashtu, komuna ka edhe planin Zhvillimor Urban

2012-2022. Aktualisht komuna ka bërë përgatitjet për hartimin e hartës zonale si dokument fillestar për krijimin e strategjisë, pas së cilës do të krijohet Plani i ri Zhvillimor Komunal. Po ashtu, në këtë fazë komuna ka hartua planin rregullues urban "Zona Qendër", ku janë përcaktuar përgjegjësit dhe buxheti i nevojshëm për të.

Gjatë vitit 2017, komuna kishte paguar gjithsej 242,263€ për faturat e viteve paraprake derisa në PFV janë deklaruar vetëm 210,161€ me të përfunduar viti fiskal 2016 si fatura të papaguara. Kjo nënkupton që të paktën për shumën 32,103€ obligimet e vitit 2016 janë nën deklaruar dhe Komuna për vitin 2017 nuk i kishte deklaruar tri shuma obligimesh ndaj furnitorëve për gjithsej 1,019€

Përkundër direktivave të Rregullores 02/2010 për Procedurat e Rekrutimit në Shërbimin Civil, neni 4, sipas të cilave në rast se nuk ka kandidatë nga nëpunësit ekzistues, atëherë zhvillohet procedura e hapur e rekrutimit, Komuna nuk e kishte mbyllur pozitën e udhëheqësit të prokurimit që nga janari 2017, me ç' rast ish udhëheqësi i pensionuar ishte angazhuar me kontratë mbi vepër si ekspert i prokurimit, dhe Kryetari i Komunës, kishte autorizuar një zyrtar të prokurimit për nënshkrimin e kontratave deri në zgjedhjen e udhëheqësit të prokurimit. Sipas ligjeve në fuqi këto kontrata nuk duhet të tejkalojnë periudhën gjashtë mujore

## 6

## Rekomandime

1. Kryetari duhet të sigurohet se procesi i përgatitjes së buxhetit dhe planifikimit të jenë në përputhje me nevojat e qytetarëve dhe afatet e realizimeve, me qëllim të evitimit të vonesave në realizimin e projekteve.
2. Kryetari duhet të plotësoj pozitën e udhëheqësit të prokurimit sipas ligjeve në fuqi.
3. Kryetari duhet të sigurohet që rekomandimet e vitit paraprak adresohen në mënyrë aktive.
4. Kryetari, duhet të sigurojë që aranzhimet e qeverisjes janë rishikuar në mënyrë kritike dhe janë ndërmarrë veprimet e duhura për përmirësimin e aranzhimeve të llogaridhënies dhe raportimit menaxherial.





# KOMUNA E ISTOGUT



“Opinionimi i Auditorit për Komunën e Istogut për vitin 2017 është i ipamodifikuar me theksim të çështjes.”

RAPORTI I AUDITIMIT PËR PASQYRAT FINANCIAR  
VJETORE TË KOMUNËS SË ISTOGUT PËR VITIN E  
PËRFUNDUAR MË 31 DHJETOR 2017







### 3 Krahاسimi i çështjeve 2015-2017

Raporti i auditorit për PFV-të e vitit 2016 të Komunës së Istogut ka rezultuar me 16 rekomandime. Deri në fund të auditimit për vitin 2017, vetëm katër (4) rekomandime janë zbatuar plotësisht, katër (4) ishin në proces të zbatimit, ndërsa tetë (8) nuk janë zbatuar ende. Po ashtu, nga viti 2015 ishin bartur edhe 13 rekomandime, dhe në vitin 2017, një (1) nga to është zbatuar, dy (2) rekomandime tjera janë në zbatim e sipër dhe 10 nuk janë zbatuar ende. Tabela në vijim pasqyron rekomandimet e ZKA për periudhën 2015-2016-2017.




## Çështjet e identifikuar nga ZAK-ja 2015-2017 për Komunën e Istogut

	2017	2016	2015
1	Një pjesë e shpenzimeve janë buxhetuar dhe shpenzuar gabimisht në kategoritë joadekuat	Prezantimi jo i drejtë të pasqyrave financiare sipas Standardeve Ndërkombëtare të Kontabilitetit në Sektorin Publik - Raportimi Financiar bazuar në Kontabilitetin e Parasë së Gatshme	Implementimi i rekomandimeve nga viti paraprak
2	Nivel i ulët i realizimit të buxhetit për investime kapitale	Zbatimi i rekomandimeve nga viti paraprak	Lista kontrolluese e vetëvlerësimit
3	Mos verifikimi i gjendjes aktuale të pronave	Pyetëtori i vet-vlerësimit	Moszbatimi i kërkesave për Menaxhimin e rrezikut
4	Menaxhim jo adekuat i pronave komunale të dhëna me qira	Mungesa e planeve strategjike të zhvillimit dhe planeve tjera	Dobësi në Kontrolllet Menaxheriale
5	Dobësi në angazhimin e stafit sipas marrëveshjeve për shërbime të veçanta	Dobësi në kontrolllet menaxheriale	Funksionimi i NJAB dhe komitetit të auditimit
6	Hyrja në obligime pa disponueshmëri të mjeteve buxhetore	Mos realizimi i planit të auditimit nga NjAB	Dobësi sistematike në prokurim





## Çështjet e identifikuara nga ZAK-ja 2015-2017 për Komunën e Istogut

			
7	Mangësi në vendosjen e kritereve tek aktiviteti i prokurimit	Realizimi i buxhetit	Dobësitë jo sistematike të prokurimit
8	Mosrespektim i procedurës për konfiskimin e sigurisë së tenderit	Dhënia e tokës bujqësore me qira	Pagesat sipas marrëveshjes si dhe kontrata për shërbime të veçanta
9	Nënshkrimi i kontratave pa mbulesë të fondeve për vitin pasues	Mos aprovimi me kohë i lejes së ndërtimit	Mos harmonizim i pozitave të punës në mes kontratave dhe listës së pagave
10	Mosrespektim i legjislacionit përkatës në formimin e komisioneve të vlerësimit.	Mos verifikimi i gjendjes aktuale të pronave	Mungesa e dëshmive me rastin e përzgjedhjes së përfutuesve
11	Pagesa pa dëshmi të mjaftueshme	Kontratë jashtë planit të prokurimit dhe mungesë zotimi të mjeteve	Tatimi në pronë
12	Mangësi në menaxhimin e pasurisë	Lidhja e kontratës me ofertuesin e papërgjegjshëm	Të hyrat nga dhënia me qira e pronës komunale
13	Vonesa në pagesën e faturave dhe mos raportim i obligimeve	Mos aplikimi i librit ndërtimor	Mungesa e regjistrimit të plotë të pasurive dhe mos pajtueshmëri me rregulloren e menaxhimit të pasurive
14	Nivel i ulët i zbatimit të rekomandimeve nga vitet paraprake	Keqklasifikim në kode ekonomike adekuate	Menaxhimi i dobët i llogarive të arkëtueshme
15	Funksionimi i kufizuar i NjAB-së dhe KA-së	Dobësi në menaxhimin e pasurisë	Mos raportimi i obligimeve të papaguara në pajtim me rregulloren e thesarit
16	Dobësi në kontrollet menaxheriale dhe menaxhimin e rrezikut	Vonesa në pagesën e faturave dhe mos raportimi në MF	










# LISTA E RAPORTEVE TË AUDITORIT:

- Raporti i auditimit për pasqyrat financiar vjetore të komunës së Prizrenit për vitin e përfunduar më 31 dhjetor 2017 ([http://www.zka-rks.org/wp-content/uploads/2018/06/RaportiAuditimit\\_KPZ\\_2017\\_Shqip.pdf](http://www.zka-rks.org/wp-content/uploads/2018/06/RaportiAuditimit_KPZ_2017_Shqip.pdf))
- Raporti i auditimit për pasqyrat financiar vjetore të komunës së Suharekës për vitin e përfunduar më 31 dhjetor 2017 ([http://www.zka-rks.org/wp-content/uploads/2018/06/RaportiAuditimit\\_KSU\\_2017\\_Shqip.pdf](http://www.zka-rks.org/wp-content/uploads/2018/06/RaportiAuditimit_KSU_2017_Shqip.pdf))
- Raporti i auditimit për pasqyrat financiar vjetore të komunës së Ferizajt për vitin e përfunduar më 31 dhjetor 2017 ([http://www.zka-rks.org/wp-content/uploads/2018/05/RaportiAuditimit\\_KFE\\_2017\\_Shqip.pdf](http://www.zka-rks.org/wp-content/uploads/2018/05/RaportiAuditimit_KFE_2017_Shqip.pdf))
- Raporti i auditimit për pasqyrat financiar vjetore të komunës së Lipjanit për vitin e përfunduar më 31 dhjetor 2017 ([http://www.zka-rks.org/wp-content/uploads/2018/06/RaportiAuditimit\\_KLIP\\_2017\\_Shqip-1.pdf](http://www.zka-rks.org/wp-content/uploads/2018/06/RaportiAuditimit_KLIP_2017_Shqip-1.pdf))
- Raporti i auditimit për pasqyrat financiar vjetore të komunës së Podujevës për vitin e përfunduar më 31 dhjetor 2017 ([http://www.zka-rks.org/wp-content/uploads/2018/05/RaportiAuditimit\\_KPD\\_2017\\_Shqip.pdf](http://www.zka-rks.org/wp-content/uploads/2018/05/RaportiAuditimit_KPD_2017_Shqip.pdf))
- Raporti i auditimit për pasqyrat financiar vjetore të komunës së Istogut për vitin e përfunduar më 31 dhjetor 2017 ([http://www.zka-rks.org/wp-content/uploads/2018/05/RaportiAuditimit\\_KIS\\_2017\\_Shqip-2.pdf](http://www.zka-rks.org/wp-content/uploads/2018/05/RaportiAuditimit_KIS_2017_Shqip-2.pdf))







KDI është Organizatë Joqeveritare (OJQ) e angazhuar të mbështesë zhvillimin e demokracisë përmes përfshirjes së qytetarëve në bërjen e politikave publike dhe fuqizimin e sektorit të shoqërisë civile me synimin për të ndikuar në rritjen e transparencës dhe llogaridhënies nga ana e institucioneve publike.

Për më shumë informata rreth KDI ju lutem vizitoni [www.kdi-kosova.org](http://www.kdi-kosova.org)

Me përkrahjen financiare të:

